



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.316/10 prot.

Datë 18.03.2026

V E N D I M

Nr. 407/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga,

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.03.2026 mori në shqyrtim çështjen me

Objekt: Korrigjim vendimi.

Kërkuesi: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “SoLed” SHPK me NIPT M42026032D dhe adresë: Kompleksi Lake Vieë, Rruga Kristo Luarasi, Godina B, Kati 4, Hyrja B03, Tiranë

Agjencia e Prokurimit Publik.
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit

të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik,

I Vëren:

I.1. Me shkresën nr.323/12 prot., datë 12.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 316/8/ prot., datë 17.03.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik me lëndë “Kërkesë për korrigjim vendimi” për rishikim të vendimit të KPP nr.364/2026 datë 09.03.2026.

I.2. Në pjesën arsyetuese në faqen 44 (dyzet e katër) pika III.3.6 të vendimit të KPP nr. 364/2026 datë 09.03.2026, përcaktohet si më poshtë vijon:

“III.3.6. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë për kriterin e përcaktuar në pikën 2.3. të kapacitet teknik, pika 1, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për vlerën limit të kontratave të ngjashme të realizuara, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të lex specialis, si dhe nenit 41 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, që për të verifikuar përmbushjen e aftësive teknike të mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor të kërkojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Nga verifikimet rezulton se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3. të kapacitetit teknik pika 1 në lidhje me vlerën limit të kontratave të ngjashme të kryera nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 41 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në lidhje me formulimin dhe vlerën limit të kontratave të ngjashme sipas parashikimeve të nenit 41 pika 3 të aktit nënligjor të mësipërm, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.”

I.3. Në këtë paragraf vërehet se është përmendur neni 41 pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, nën i cili i referohet kërkesave të

veçanta për kontratat e shërbimeve., *ndërkohë që procedura e prokurimit objekt ankese është “mall”.*

I.4. Me shkresën nr.323/12 prot., datë 12.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 316/8/ prot., datë 17.03.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik me lëndë “Kërkesë për korrigjim vendimi” për rishikim të vendimit të KPP nr.364/2026 datë 09.03.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Referuar informacionit dhe dokumentacionit sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik,

Arsyeton:

II.1. Në kuptim e zbatim të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), *Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij (neni 24/1 i LPP).*

II.2. Institutit i korrigjimit nga ana e një organi administrativ të një vendimi të nxjerrë nga vetë organi në fjalë, gjen mbështetje ligjore në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”, i cili në nenin 112 të tij, parashikon se:

- “1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij...”*

II.3. Me kërkesë të autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon që, në Vendimin e tij Nr. 364/2026 datë 09.03.2026, të bëjë korrigjimin në pjesën pjesën arsyetuese në faqen 44 (dyzet e katër) pika III.3.6 të vendimit të KPP nr. 364/2026 datë 09.03.2026 duke përcaktuar referencën ligjore për kontratën e mallrave si më poshtë:

Ishte

“III.3.6. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë për kriterin e përcaktuar në pikën 2.3. të kapacitet teknik, pika 1, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për vlerën limit të kontratave të ngjashme të realizuara, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore

në fuqi, në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të lex specialis, si dhe nenit 41 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, që për të verifikuar përmbushjen e aftësive teknike të mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor të kërkojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Nga verifikimet rezulton se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3. të kapacitetit teknik pika 1 në lidhje me vlerën limit të kontratave të ngjashme të kryera nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 41 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në lidhje me formulimin dhe vlerën limit të kontratave të ngjashme sipas parashikimeve të nenit 41 pika 3 të aktit nënligjor të mësipërm, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.”

Bëhet

“III.3.6. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë për kriterin e përcaktuar në pikën 2.3. të kapacitet teknik, pika 1, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për vlerën limit të kontratave të ngjashme të realizuara, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të lex specialis, si dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, që për të verifikuar përmbushjen e aftësive teknike të mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor të kërkojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Nga verifikimet rezulton se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3. të kapacitetit teknik pika 1 në lidhje me vlerën limit të kontratave të ngjashme të kryera nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 40 pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në lidhje me formulimin dhe vlerën limit të kontratave të ngjashme sipas parashikimeve të nenit 40 pika 4 të aktit nënligjor të mësipërm, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron”.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, si dhe nenit 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë kërkesën e e autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, për rishikim të vendimit të KPP nr. 364/2026, datë 09.03.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operator, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi”, me REF-74336-01-22-2026 me objekt: “Blerje Materiale mjekimi kirurgjikale, për 12 muaj”, me fond limit 19 165 372 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH ose 198,728.45 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e tetë pikë dyzet e pesë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Të korigjojë Vendimin Nr. 364/2026, datë 09.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik në pjesën pjesën arsyetuese në faqen 44 (dyzet e katër) pika III.3.6, duke saktësuar referencën ligjore për kontratat e mallrave.
3. Të gjitha pjesët e tjera të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 364/2026, datë 09.03.2026, mbeten të pandryshuara.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

